REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PA1.nr.1363/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Hashim Çollaku, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Cacaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.D., për shkak të veprës penale të Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, P.nr.154/2017 të datës 28.06.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16.12.2020 mori këtë:

A K T GJ Y K I M

I. Me rastin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë e sipas detyrës zyrtare ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, P.nr.154/2017 të datës 28.06.2019, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës ndaj të akuzuarit D.D. përkitazi me veprën Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor, e refuzon akuzën në kuptim të nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së, lidhur me nenin 106 par. 1, pika 1.5, lidhur me nenin 107 par. 8 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

II. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, me aktgjykimin P.nr.154/2017 të datës 28.06.2019 të akuzuarin D.D., e ka liruar nga akuza për shkak të kryerjes së veprës penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409

par.1 të KPRK-së. Shpenzimet e procedurës penale bien mbi barrën e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta anuloj ashtu që të çështja ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1377/2019, datë 17.12.2019, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit, ndërsa çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPPK-së, gjeti se:

- Me rastin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë e sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë detyrimisht duhet ndryshuar sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën për të cilën është ushtruar ankesa dhe sipas detyrës zyrtare, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, përkitazi lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret e drejta në ndjekje penale është parashkruar.

Nga shkresat e lëndës del se i akuzuari D.D. është liruar nga akuza për kryerjen e veprës penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 të KPRK. I akuzuari J.B. është liruar nga akuza për kryerjen e veprës penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 të KPRK për të cilën parashihet dënimi me burgim prej 3 (tre) muaj deri në 3 (tre) vjet. Sipas dispozitës së nenit 106 par. 1 pika 1.5 të KPRK-së, për veprën penale të dënueshme me më shumë se 1 (një) vit burgim, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 3 (tre) vite nga koha e kryerjes së veprës penale (parashkrimi relativ), ndërsa sipas dispozitës së nenit 107 par.8 të KPRK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Nga shkresat e lëndës, rezulton se vepra penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 të KPRK është kryer me datë 22.08.2014, kurse afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale fillon të rrjedhë nga data kur është kryer vepra penale. Në rastin konkret, vepra penale është kryer me datë 22.08.2014. Duke pasur parasysh se prej kohës së kryerjes së veprës penale

(22.08.2014) e deri më tani, kanë kaluar më tepër se 6 (gjashtë) vite, aktgjykimi i ankimuar është dashur të ndryshohet sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës penale konform dispozitës së nenit 454 par. 1 të KPPK-së bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitës së nenit 403 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1363/2019, datë 16.12.2020

Zyrtari ligjor, **Kryetari i kolegjit-gjyqtari,**
Bajram Cacaj **Afrim Shala**

Anëtaret e kolegjit:

Shqipe Qerimi

Hashim Çollaku